



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KËSHILLI I QARKUT SHKODËR
KRYETARE**

Nr. 482/1 Prot.

Shkodër, më 04.01.2024

V E N D I M

Nr.19 Datë 28.12.2023

« Mbi disa ndryshime Mbi prioritetet e Keshillit te Qarkut Shkoder »

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e datës 28.12.2023, me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 77, 78,83 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, paragrafi 130 i Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", bazuar në ligjin nr.97, datë 07.12.2023, "Për buxhetin e vitit 2024", bazuar ne Vendimin e Keshillit te Qarkut Shkoder nr.52 date 23.12.2016 "Mbi prioritetet e KQSH", Vendimin e Keshillit te Qarkut Shkoder nr.20, date 26.05.2017"Mbi disa ndryshime ne VKQ nr.52,date 23.12.2016 ", Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **15 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,**

VENDOSI;

1. Në vijim të pikës 1 dhe 1.1 të VKQ Shkodër nr.20, datë 26.05.2017, të miratojë investimet prioritare si më poshtë;
 - 1.a-Investimi; Rikonstruksion i rrugës Trush i poshtëm, Bashkia Vau Dejës.
 - 1.b-Investimi; Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës.
2. Këto investime do jenë pjesë e buxhetit të Këshillit te Qarkut Shkodër për vitin 2024 dhe PBA-së 2024-2026, pas nënshkrimit të marrëveshjes mes dy njësive të vetëqeverisjes vendore, si investime prioritare të Bashkisë Vau Dejës, shpallur me Vendim te Këshillave Bashkiakë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

**KRYETARE
Marina DUHANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

LENDË: « Mbi disa ndryshime Mbi prioritetet e Keshillit të Qarkut Shkoder »

Këshilli i Qarkut Shkodër duke pasur prioritet harmonizimin e politikave të zhvillimit rajonal e konsideron të rëndësishëm të kontribuojë në rehabilitimin e infrastruktures ndërkomunale. Këshilli i Qarkut Shkodër në objektivat e tij ka konsideruar dhe konsideron të rëndësishme zhvillimin ekonomik të zonave të territorit duke lehtësuar banorët e saj për të pasur akses në tregun rajonal të produkteve si dhe në tregun e punës.

Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal të Qarkut Shkodër në masat e saj për Infrastrukturen dhe Shërbimet, Turizmi dhe Bujqësinë parashikojnë rehabilitimin e rrugëve ndërkomunale për të pasur akses në tregun e rajonal me produktet tipike të zonës. Gjithashtu në dokumentin strategjik të rishikuar “Skenaret e Zhvillimit Nenrajonal të Qarkut Shkodër” në masat dhe nënmasat e tij parashikohen projekte që kanë për qëllim përmirësimin e projekteve dhe infrastruktures ndërkomunale.

- ✓ Investimi i segmentit rrugor rural në fshatin Trush i poshtëm është pjesë e Njesisë Administrative Berdise. Rruga e cila parashikohet të investohet lidh territoret e dy Bashkive atë të Bashkisë Vau Dejës dhe të Bashkisë Shkodër, ky segment përmirëson infrastrukturen e rrugore e cila bëhet me lehtësues për turistët që vijnë nga Bashkia Vau Dejës drejt plazhit të Velipojës dhe anasjelltas lehtësojnë aksesin e turistëve drejt territorit të Bashkisë Vau Dejës.
Gjithashtu kjo rrugë lehtëson aksesin e banorëve të fshatrave përreth drejt tregjeve me të afërta dhe do intensifikojë ndërveprimin mes komuniteteve të fshatrave përreth në Shkodër e Vau Dejës.
- ✓ Zona e cila është parashikuar të përfitojë nga sistemimi i rrugës së varrezave i përket fshatit Melgushe, Bashkia Vau i Dejës të Qarkut Shkodër. Fshati Melgushe i Bashkisë së Vau Dejës gjendet në pjesën perëndimore dhe ka akses pranë rrugës nacionale Shkodër-Tiranë. Rikonstruksioni i rrugës së varrezave lehtëson aksesin e banorëve për tek varrezat për kryerjen e ritualeve dhe shërbesave të komunitetit të zonës si dhe lehtëson gjithashtu aksesin me rrjetin infrastrukturor të brendshëm të fshatit.

**P/Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës,
Kastriot Kruja
Gjyljana Miruku**

